

VENDIM
Nr. 1, datë 7.1.2016

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES, PËR AGJENCINË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2016, t’i shtohet fondi prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2016, ndërsa fondi prej 6 000 000 (gjashtë milionë) lekësh, të përballohet nga fondet e planifikuara për AIDA-n, për vitin 2016. Fondi në total prej 36 000 000 (tridhjetë e gjashtë milionë) lekësh të përdoret për promovimin e Shqipërisë në mediat ndërkombëtare.

3. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve autorizohet për menaxhimin, kryerjen e procedurave dhe administrimin e shërbimit, si dhe të veprimeve financiare.

4. Ky vendim i fillon efektet financiare pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”.

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI A

**TABELA E PËRDORIMIT TË FONDIT PËR PUBLIKIMIN NË REVISTËN
NDËRKOMBËTARE**

Zërat e kostove të promovimit	2016	Kostoja totale, lekë
Pagesa e kompanisë	2,000,000	2,000,000
Publikimi në revistën	24,000,000	24,000,000
Konceptimi dhe zhvillimi i përmbajtjes	4,000,000	4,000,000
1500 kopje të personalizuar me logon e Shqipërisë	1,000,000	1,000,000
Totali	31,000,000	31,000,000
Tatim në burim 15%		5,000,000
TOTALI		36,000,000